

“ KRYEVEPRA E PANJOHUR “

- Të ndodhet ndonë gjë për të shkruar?

- Jo!

Bënte shumë natë. Sapo kishin filluar të binin pikat e para të shiut. Vetëtinte diku larg. Kalimtarët po rralloheshin në rrugë. Edhe miqtë tanë u ngritën, n'a përshëndetën dhe shkuan në punë të tyre njeri pas tjetrit. Mbeta vetëm me Asimin. Pinim kafën dhe shihnim reflektimin tonë tek xhamat e errët të lokalit. Dukeshim si dy fantazma. Trupat tanë i përshkonin kalimtarët që nxitonin për në shtëpi, makinat që ecnin me shpejtësi, fshesaxhiun e lagjes dhe qentë vagabondë që zhyteshin tek kazani i plehërave...

Më ishte bërë zakon të kthehesha tek klubi i Myftarit dhe t'a përshëndesja Asimin pothuajse çdo natë. Sapo kishte mbërritur në Tirane sëbashku me familjen.

- Çfarë do të shkruash?

- Dua të të tregoj diçka.

Filloi të kërkonte në xhepat e xhaketës. Kërkonte sa në një xhep në tjetrin. Insistonte disa herë në të njëjtin. Dukej sikur xhepi do të lodhej e do t'ja jepte atë që kërkonte me aq ngulm. E vështroja insistimin e tij me një buzëqeshje të lehtë. Më shëmbëllente me një femije të vogël që donte t'i shkonte e tija deri në fund. Papritmas, u ngrit nga tryeza dhe u drejtua për tek kamarieri. Ectë lehtë...si ne ajër. Ishte i gjatë, i dobët, syzi. Dikush, që tani nuk më kujtojet, me pati thënë, se ne rini i shëmbëllente Davidit të Mikelanxhelos. U kthye me një stilolaps në dorë dhe me disa letra faturash të lokalit. U ul i kënaqur. Psherëtiu thellë duke u përkulur mbi tavolinë dhe filloi të shkruante, por stilolapsi nuk linte gjurmë, veçse gërvishte letrën. Lëshonte klithma. Asimi tentoi disa here, por më kot.

- Është stilolaps memec.

Gërvishti në letër një paraleliped vertikal e ndërkohë, që përpëlitej të shkruante, filloi të më tregonte projektin e veprës së tij, që do t'a niste fill sapo të përfundonte lufta. U ngrit në këmbë

dhe me duar bëntë shenjën e një kollone në ajer. Çonte duart sa lart poshtë dhe sytë i mbante sipër, gjysëm të mbyllur. M'u bë, sikur vepra rrinte e mbaruar përpara nesh.

- Do t'a bëj të zezë... Një të zeze brilante... Një të zezë, që të vezullojë nga larg. Një të zezë verbonjëse. Në të, do të vendos figurat dhe shkrimet... por ky drej stilolapsi nuk do, që nuk do të shkruajë.

Fliste me ndërprerje dhe me një tension, që rrallë e kisha parë tek dikush tjetër. Ndërkohë, sytë e zinj i shkëlqenin dhe për një çast m'u shfaqën në një të errët verbuese, si vepra e tijë. M'i kishte ngulur sytë, por nuk më shihte mua. Vështrimi i tijë, projektohej diku larg, ndoshta atje ku dëshironte të vendoste monumentin e tijë. Pastaj, më përshkruante si i përhumur figurat që do gdhëndëte në të. Shkrimet, që do krijonin frize të gjata, ku do të derdhej mençuria e shpirtit të vendit të tij të sakrifikuar. Shkrime të gdhëndura hollë e që do të lexoheshin vetëm po t'i shkoje monumentit fare afër. Do ishin shkrime magjike, në kujtim të shpirtit të humbur. Shkrime si për gur varri. Shkrime si për sinor, midis një bote këndeje e një bote andej. Hieroglifet të shenjta për një sakrifice të shenjtë.

- Do t'a bësh si “ Rrasa e inteligjences së zezë “ !?

Ndërkohe që flisnim, tensioni i fillimit filloi të platitej dhe shpirti i tij u bë si një bunacë. U bë një qetësi, ku nuk pipëtinte më asgjë. U shëmb në karrike. Piu gllënkën e fundit të kafesë dhe pa me ngulm llumin në fund të filxhanit.

- Ja, si ky llumi këtu, i errët si një grope thithëse. Por une, do t'a bëj vertikale e të ngrirë në gur. Këtë dua të bëj. Dua që të shihet që larg dhe, që të të ndjellë t'i afroresh e t'a prekësh, prandaj do t'a bëj të lëmuar, që duart e njerëzve kur t'a prekin të ndjejnë përkëdheli, dashuri, muzikë dhe të ëndërojnë qetësinë. Jemi shumë të lodhur! Kemi hequr shumë! Fat i keq si llum kafeje!

Fliste dhe shkrepinte si një stuhitë e egër pas asaj bunace të shurdhët. Unë kisha ndrojtë t'a ndërprisja. Mbështeta mjekrën në duar dhe u perqëndrova që të mos t'i tretej asnjë fjalë. Fliste me një vendosmëri sikur gdhëndëte. Ishte klithma e krijuesit të dëshpëruar që kish humbur shumë gjëra të dashura në luftën e

mallkuar, përzjerë me klithmën e njeriut që ende nuk kish humbur gjënë më të çmuar...shpirtin. Kishte humbur shtëpinë, veprat, fotot, projektet...e më pas vëllanë e shtrenjtë. Të gjitha j'a kishte ngrënë lufta. Lufta që e uritur dhe në stomakun e sajë ishin trazuar të gjitha, perzierë me gjak e mish njeriu. Asimi kish qenë shumë pranë asaj. Kish qenë mu në mes të stomakut të sajë, por nuk kish humbur. Kishte shpëtuar ai vetë, e shoqja dhe dy fëmijët e tijë. Por, pak çaste më vonë, ky shpëtësim nuk e kish qetësuar. E mundonte mendimi se njeriu mund të humbiste lehtësisht thelbin e qeniës së tijë. Asimi kishte mundur të shpëtonte memorjen. Atë nuk j'a kishin djegur. Kishin mbërritur t'i regjistronin në të, djegjet, vrasjet, tmerret, por Asimi e ruajti në pjesën më të thellë të qenies, në errësirën e madhe. Ajo po fliste tani. Po dilte në sipërfaqe e përgjumur dhe të tromaksur, prandaj fjalët dukeshin si të palatuara, të egra, bërtitese, çjerrëse, plot dufe e mllefe. Me to, po ngjizej vepra e tij. Vepra që po m'a rrëfente mua.

- Askujt nuk j'a kam thënë këtë! Nuk po di, pse po ta them ty sot!? Por për dreq, nuk po më shkruan kjo pena!!!

- E kuptova Asim, nuk ka nevojë për penën. E pashë dhe e shijova veprën tënde. Do jem shumë i lumtur ta bësh, sepse do jetë një veper e madhe.

...

Kjo natë mu kujtua menjëherë, kur më thane se Asimi ndërroi jetë. Mbeta tek dera e studios si në boshllëk.

- Pse vdiq?!

M'u duk pyetja më pa vend në botë, por kisha të drejtë t'a bëja. Hyra brenda dhe u shëmba në divan. I hodha një sy shkarazi pikturës tek kavaleti, dhe m'u duk e pakuptimtë. Nuk pyeta nëse ai e kishte kryer veprën e tij apo jo. Nuk dija kë të pyesja. Më vinte turp, pasi më pas nuk u pamë më dhe nuk degjova më asgjë rreth tij. Ishim ndare, sikur të mos ishim takuar kurrë!

Asim i dashur,
e kam ruajtur me fanatizëm projektin tënd dhe kërkujt nuk j'a kam treguar deri më sot. E ruajta, dhe do t'a ruaja si një amanet tëndin, deri në ditën e realizimit! Sikurse pena që nuk shkruante, por gërvishte, ashtu më mbeti edhe mua, si një gërvishtje e thellë në memorjen time. Besoj se është koha t'a dëshmoj.
Tani që po shkruaj këto rreshta, ndjej se je pranë meje dhe po më korigjon e po m'i drejton fjalët që mos them të tepërta. Monumenti yt, nuk arriti të behej gur. Mbeti në fjalë. U bë fjalë. Ndoshta ti miku im, e ke bërë gati atje ku je, dhe n'a pret të vijmë e t'a shohim, t'a prekim e të ndjejmë dashuri, muzikë sikurse dëshiroje e në qetësi të shijojme kryeveprën tënde të panjohur.

miku yt
GAZMEND LEKA

Është teksti për artistin nga Shqipëria e Epërme, Asim Lohja